



Organ - Organizata Organi - Organizata Org. Abstr.	Dr. Prof. Dr. Prof. Part No.	16.02.2022	2 viti god year
SKIMSHCK	825/2022		1/4

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 42/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.Nr.2971/19, të datës 31.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.642/2019 të datës 22.10.2019 të parashtruar përmes adresës zyrtare (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), për ankuesin me adresë: në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit – Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.Nr.642/2019 e datës 22.10.2019, e parashtruar nga ankuesin

II. MBETET NË FUQI Vendimi Nr.654/2019 i datës 20.09.2019 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së Punës nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi, nëpunës civil “jo karrierës” i përzgjedhur me procedurë të rekrutimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pozitë „Zyrtar i Lartë Ligjor”, në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit/Departamenti Ligjor, në periudh të caktuar sipas konkursit të shpallur me datë 22.06.2017, ka ushtruar detyrën e punës me kohë të caktuar sipas Akt emërimit të datës 14.09.2017 me nr.ref:DL-10/2017, duke filluar nga data 14.09.2017 deri me datë 17.09.2019, pasi që ankuesi e ka pranuar Vendimin Nr.654 të datës 20.09.2019 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të jo karrierës, me datë 22.10.2019 ka parashtruar ankesë përmes adresës zyrtare ankesa.kpmschck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

me pretendime ankimore që të sistemohet në pozitë të lirë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në bazë të vlerësimeve të rezultateve të punës gjatë dy(2) viteve nga data 14.09.2017 deri me datë 14.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 11.11.2019 me numër protokoli 5302/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në aneksë tek Ministria e Punëve të Brendshme, e cila me datë 18.11.2019 numër protokoli 5388/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.12.2019 me numër protokoli 5737/2019, ka njoftuar ankuesin se Këshilli nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.Nr.642/2019, të datës 22.10.2019, për shkak se nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit i pakënaqur me njoftimin e datës 10.12.2019 të Këshillit, ka hapur konfliktin administrativ, në Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Me datë 13.01.2022 Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2971/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 10.12.2019, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.Nr.642/2019, të datës 22.10.2019 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2971/2019 të datë 13.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar në Këshill me datës 21.01.2022 me nr. protokoli 276/2022; Ankesë A.nr.642/2019, e datës 22.10.2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi datës 14.09.2017; Ndryshim i Akt emërimit i datës 03.07.2019; Vërtetim i datës 20.09.2019; E-mail i datës 19.09.2019; E-mail i datës 09.10.2019; E-mail i datës 06.09.2019; E-mail i datës 26.08.2019; E-mail i datës 19.09.2019; 19.09.2019;Formulari i vlerësimit i rezultateve në punës e datës 28.12.2018; Formulari i vlerësimit i punës provuese i datës 20.12.2017; Përgjigje në ankesë e datës 18.11.2019; Konkursi i shpallur për pozitë të jo karrierës i datës 22.06.2017; Aprovimi nga MAP/DASHC -Autorizimi i datës 19.06.2017; Vendimi nr.654 i datës 20.09.2019; kërkesë për prova shtesë e datës 08.02.202.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se nga statusi i nëpunësit civil “jo të karrierës” Ministria e Punëve të Brendshme është e obliguar që ta emëroj me status të përhershëm gjegjësisht në nëpunës civil “të karrierës” pas kalimit të periudhës dy (2) vjeçar, sipas Akt emërimit të datës 14.09.2017 me nr.ref:DL-10/2017 në pozitë „Zyrtar i Lartë Ligjor”, në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit/Departamenti Ligjor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ankuesi gjithashtu pretendon se ka edhe vlerësimet e punës të kënaqshme dhe i plotëson kushtet për një gjë të tillë.

Kolegji, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka bërë analizën e tyre në përputhje me dispozitat ligjore gjegjësisht neni 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i cili përcakton se: *“pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë”*, prandaj ankuesi bazuar në këtë dispozitë ligjore ka

themeluar marrëdhënien e punës në MPB, përkatësisht sipas konkursit të datës 22.06.2017 në të cilin konkurs është përcaktuar saktë kohëzgjatja e kontratës dhe është sqaruar qëllimi i shpalljes që ka qenë zëvendësimi i nëpunësit civil të përhershëm për shkak se nëpunësi civil i përhershëm është emëruar funksionar publikë dhe ka bërë pezullim të dakorduar të vendit të punës si kategori ligjore në përputhje me nenin 89 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës që ka qenë në fuqi.

Kolegji, po ashtu ka pasur parasysh se akti i emërimit të ankuesit ka qenë në afat nga data 14.09.2017 deri me datë 17.09.2019, ndërsa marrëdhënia e punës i ka përfunduar me datë 20.09.2017 sipas Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së me nr. 654/2019 të datës 20.09.2019, prandaj Kolegji konstaton se vendimi i tillë është në përputhje me ligjin Nr.03/L-149 për SHCK gjegjësisht me:

Neni 90

Përfundimi i marrëdhënies së punës

...

2.3. përfundimin e afatit për punësimet me afat të caktuar sipas këtij ligji;

...

Kolegji, ka trajtuar me kujdes vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm por ka konstatuar se Sekretari është në një pozicion i cili i din më së miri nevojat për personel në kuadër të institucionit të cilin e udhëheq si Zyrtares Kryesor Administrativ sa i përket nëpunësve civil të punësuar në institucion përkatësisht në këtë rast në Ministrinë e Punëve të Brendshme, prandaj me rikthimin e nëpunësit civil të përhershëm, Kolegji merr të ligjshëm ashtu siç është theksuar më lartë dhe të mirëqenë vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së dhe në harmoni me nenin 18 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ku përcaktohen se:” ***1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror***”,.....***3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:.....3.6.vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi***”, që në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pajtim me përgjegjësit e tij kryesore lidhur me menaxhimin e administratës dhe burimet financiare, mbi këtë bazë ka vendosur që ankuesit tij përfundoj marrëdhënien e punës, me Vendimin Nr.654/2019 të datës 20.09.2019, pas kalimit të afatit të Akt emërimit të jo karrierës të datë 14.09.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.654/2019 të datës 20.09.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregullores Nr.01/2011për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A. Nr.42/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Gjykatës Themelore-Prishtinë, Gjyqtares Luljeta Maxhuni,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së .